



STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

**Për Njoftim të Menjëhershëm:** 5 nëntor 2012

**GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NENSHKRUAN URDHERIN EKZEKUTIV PER  
TE LEHTESUAR VOTIMIN SHTETASIT E NJU JORKUT QE U PREKTEN NGA  
URAGANI SENDI (HURRICANE SANDY)**

Guvernatori Endrju M. Cuomo (Andrew M. Cuomo) nënshkroi sot një urdhër ekzekutiv që do të lehtësojë mjaft votimin për shtetasit e Nju Jorkut që u prekën nga Urangani Sendi (Hurricane Sandy). Urdhëri Ekzekutiv parashikon se çdo votues që është i regjistruar në një qark të deklaruar nga federata si në katastrofë mund të votojë në një fletë-votimi në çdo qendër votimi në Shtetin e Nju Jorkut, pavarësisht se ku është regjistruar. Përveç kësaj, Urdhëri Ekzekutiv gjithashtu kërkon që çdo bord zgjedhor në Shtetin e Nju Jorkut të dërgojë një fletë-votimi të tillë në bordin zgjedhor ku votuesi është regjistruar në fakt, në mënyrë që vota të numërohet në vendin e duhur. Një votë e tillë do të llogaritet për postin e Presidentit e të Senatorit të Shteteve të Bashkuara dhe për çdo kandidat tjetër dhe iniciativë të votës që shfaqet në fletë-votimin zyrtar ku votuesi është i regjistruar.

Personat e parë në vend dhe punëtorët e emergjencës të përfshirë në përpjekjet e rimëkëmbjes nga Urangani Sendi (Hurricane Sandy) janë gjithashtu të përfshirë në Urdhërin Ekzekutiv nëse banojnë në një nga qarqet e deklaruar nga federata si në katastrofë.

Shtetasit e Nju Jorkut duhet të provojnë që të votojnë në qendrën e rregullt të tyre të votimit. Nëse nuk mund të shkojnë në qendrën e tyre të votimit ose qendra e tyre është e mbyllur, vetëm atëherë duhet të votojnë në një vend tjetër. Votat e vetme që do të llogariten janë votat që votuesit do të lejoheshin të hidhnin në mënyrë të ligjshme në qendrën e rregullt të tyre të votimit.

Qarqet e deklaruar nga federata si në katastrofë përfshijnë: Bronks, Kings, Nasau, Nju Jork, Kuins, Riçmond, Roklend, Suffolk e Uestçester.

“Uragani Sendi (Hurricane Sandy) tashmë ka ndërprerë jetën e një numri të panumërt të shtetasve të Nju Jorkut, por nuk do të lejojmë që të ndërpresë asnjë që përpigjet të ushtrojë të

Albanian

drejtën më thelbësore nga të drejtat demokratike: të drejtën për të votuar,” tha Guvernatori Cuomo. “Edhe në kohërat e tragjedisë dhe vuajtjeve të mëdha, shtetasit e Nju Jorkut e kuptojnë se duhet të vazhdojmë të bëjmë gjithshka që mundemi për të ruajtur integritetin e sistemit tone. Kjo është se pse Shteti është duke bërë çdo përpjekje për të siguruar se votuesit që janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre për shkak të stuhisë ende do të jenë në gjendje të bëjnë që zërat e tyre të dëgjohen në Ditën e Zgjedhjeve.”

Bordet Zgjedhorë të Qarqeve (CBE-të) u udhëzuan të përdorin të gjitha mjetet në dispozicion që:

1. Të njoftojnë inspektorët zgjedhorë dhe të vendosin dispozitat e Urdhërit Ekzekutiv dukshëm në faqet në internet të bordeve dhe në qendrat e votimit në Shtetin e Nju Jorkut, duke dhënë udhëzime sesi të zbatohet një Urdhër i tillë;

2. Të udhëzojnë punëtorët e qendrave që të sigurojnë fletë-votimi dhe udhëzime për votuesit në përputhje me Urdhërin

3. Të sigurojnë njoftime dhe udhëzime për votuesit në përputhje me këtë Urdhër Ekzekutiv që tregon se

- votuesit që banojnë në qarqet e Nasaut, Roklendit, Safolkut ose Uestçesterit ose në Qytetin e Nju Jorkut mund të marrin dhe të plotësojnë një fletë-votimi në çdo qendër votimi në Shtetin e Nju Jorkut
- vota e votuesit do të llogaritet për postin e Presidentit dhe të Senatorit të Shteteve të Bashkuara dhe do të llogaritet gjithashtu për çdo kandidat tjetër për poste dhe qarqe, si dhe për çdo iniciativë të votes që shfaqet në fletë-votimin zyrtar në qarkun e banimit të votuesit.

Për shembull, një votues që qëndron me familjen në Qarkun e Oranxhit që u zhvendos nga Uestçesteri do të ketë të drejtë të votojë për garat e të gjithë shtetit dhe për Gjykatën Supreme (sepse ato dy qarqe kane një rreth gjyqësor të përbashkët) dhe ndoshta një garë për Kongresin ose Senatit të Shtetit. Një votues që kërkoi strehim më tej më lart në shtet mund të ketë të drejtë që të votojë vetëm në garat e të gjithë shtetit, pasi ata nuk kanë ndonjë post/garë tjetër të përbashkët.

Lajme të tjera të disponueshme në [www.governor.ny.gov](http://www.governor.ny.gov)  
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | [press.office@exec.ny.gov](mailto:press.office@exec.ny.gov) | 518.474.8418